



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë, më 22.11.2019
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

(shqyrtimi në parim)

Drejtuar : Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Bazuar në nenin 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datat 18, 19, 20,21 dhe 22 nëntor 2019, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, për institucionet që ky komision ka ose lidhen me fushën e tij të përgjegjësisë si:

1. Ministria e Mbrojtjes;
2. Ministria e Brendshme;
3. Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
4. Shërbimi Informativ Shtetëror;
5. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
6. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
7. Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Në mbledhjet e komisionit morën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Nga ana e të ftuarve u bë prezantimin në parim i projektbuxhetit për vitin 2020 dhe mandej të ftuarit iu përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të komisionit.

Ministri i Brendshëm, Zëvendësministri i Mbrojtjes, përfaqësues të Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, përfaqësues të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes si dhe drejtoresha e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, të shoqëruar me stafet mbështetëse, bënë prezantimin e arritjeve për institucionet e tyre, problematikat, menaxhimin e buxhetit të vitit 2019 dhe pritshmëritë e objektivat që do të arrihen me anë të buxhetit për vitin 2020.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- nenet 78, 83, pika 1, 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

➤ **OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2020**

Projekt-buxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra gjatë 6 viteve të kaluara duke pasur në fokus rritjen ekonomike, punësimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe sjelljen më afër qytetarit të shërbimeve publike si dhe përmbushjen e prioriteteve në funksion të procesit për integrimin në Bashkimin Europian.

Shpenzimet buxhetore për periudhën 2020-2022 kanë në fokus investimet publike që kanë të bëjnë me:

- Finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale
- Mbështetjen e sektorit të ujit
- Shëndetësisë
- Arsimit
- Bujqësisë

Projektbuxheti 2020 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe uljen e informalitetit, e në të njëjtën kohë synon nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Është e rëndësishme të theksohet se projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë, si: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020 ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në 2020.

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të pestin vit radhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të pestin vit radhazi. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin e 62.2% të PBB.

Projektbuxheti 2020, planifikon më shumë burime të ardhurash si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e

investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi.

➤ **DISKUTIME NË KOMISION**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në parim, u fokusua më shumë në aspektet e buxhetit të cilat trajtojnë elementet financiare për rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Komisioni analizoi me vëmendje buxhetin e parashikuar për institucionet të cilat janë përgjegjëse për çështjet e sigurisë, mbrojtjes dhe rendit publik apo dhe institucioneve që kontribuojnë në këto dy komponentë, si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Anëtarët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare gjatë diskutimit në parim të projektbuxhetit, i drejtuan pyetje të ftuarve mbi prioritetet që këto institucione duan të arrijnë me anë të këtij projekt-buxheti si dhe nëse buxheti i parashikuar për ta, plotëson nevojat për ushtrimin normal të funksioneve dhe detyrave të tyre.

Projektbuxheti i vitit 2020 në mënyrë të përmbledhur për institucionet e thirrura dhe të cilat janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit për Sigurinë Kombëtare, parashikon të arrijë:

MINISTRIA E MBROJTJES

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2020 është në shumën 24,898,845 lekë duke pasur një rritje domethënëse krahasuar me vitin 2019.

Ky trend rritës që ka ndjekur buxheti i mbrojtjes vit pas viti është në fakt prova më e qartë e vendosmërisë së qeverisë për t'ju përmbajtur angazhimeve të saja kundrejt Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe partnerëve, qoftë në terma financiarë, pra duke e rritur gradualisht buxhetin derisa të arrijë në 2% të PBB, por edhe në terma konkretë, pra në terma të modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve të forcave të armatosura, apo në terma të përballimit të kërkesave që na vinë për të kontribuar në misionet e Aleancës, por së shpejti, edhe të OKB, kudo që është e nevojshme.

Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet këtij buxheti synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA, dhe më konkretisht:

Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:

- zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.

Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.

Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.

Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile krahasuar me vitin e kaluar ka një buxhet në masën 315,000 lekë, vlerë kjo që ka ardhur në rritje.

Rritja e buxhetit për Emergjencat Civile mundëson funksionimin normal dhe ofron garanci për masat parandaluese dhe mbrojtëse për përballimin në kohë të situatave emergjente.

Drejtori i Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, z.Çako shprehu shqetësimin e detyrimeve të mbartura nga vitet e kaluara që arrijnë në masën 722,000 mijë lekë dhe se buxheti i akorduar për këtë vit nuk arrin që të shlyejë të gjithë këtë detyrim ndaj duhet gjetur një mënyrë me qëllim zvogëlimin e këtij borxhi.

Ndërkohë u vu në dukje që bashkitë dhe ministritë së bashku me institucionet qendrore bazuar në ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, kanë detyrim që të kontribuojnë për mbrojtjen civile dhe konkretisht:

Neni 65, pika 1 e ligjit të sipërcituar parashikon:

1. Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Neni 22, pika 2, gërma “b” e ligjit parashikon :

2. Ministrinë dhe institucionet qendrore kanë këto detyra:

b) planifikojnë buxhetin vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore. Për ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, arsimin, mjedisin dhe kulturën, **planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2 % deri në 4 % e totalit të buxhetit vjetor;**

Për të mundur zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, Komisioni për Sigurinë Kombëtare zhvilloi një seancë dëgjimore me ministrin e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila Denaj, me praninë e Z. Cako, Drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile dhe Z. Bekim Murati, Drejtor i AMMV-së

Pas diskutimit të kësaj çështjeje Znj. Denaj iu kërkua mundësia e nxjerrjes së një udhëzimi të përbashkët i cili të përcaktojë detyrimin që ka Ministria e Financave dhe Ekonomisë në monitorimin e zbatimit të këtyre dy dispozitave dhe unifikimin e mënyrës së veprimit të bashkive në lidhje me planifikimin e buxhetit të tyre për emergjencat civile në vlerën 4%.

AGJENCIA E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Në kuadër të miratimit të projektbuxhetit të viti 2020, AISM-së, për vitin 2020 i është parashikuar një fond në shpenzimet e përgjithshme në shumën 360,755,000 lekë, duke pasur një rritje prej 22.9% në krahasim me vitin e kaluar.

Drejtues të kësaj agjencie theksuan se kjo rritje është e kënaqshme dhe do ndikojë pozitivisht në përmbushjen e detyrave themelore dhe misionit të saj.

MINISTRIA E BRENDSHME

Buxheti, i propozuar për vitin 2020 për Ministrinë e Brendshme është **20,804,648 lekë lekë**.

Ministri i Brendshme u shpreh i kënaqur me buxhetin e akorduar për vitin 2020, pasi kjo tregon qartë vazhdimësinë e përkushtimit të qeverisë në rritjen e sigurisë dhe rendit publik në vend.

Katër janë shtyllat kryesore që synohet të jetësohen gjatë vitit buxhetor 2020:

1. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, 'kontrollin e territorit' dhe 'policimin në komunitet', të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

2. Sigurimi i rendit publik, pronës publike e private, rritja e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.
3. Përmirësimi i vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë
4. Konsolidimi i mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrimit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrimit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike

Gjithashtu, nëpërmjet këtij buxheti do të realizohen një sërë projektesh siç janë ndërtimi rishtas i Institutit të Policisë Shkencore, Korpusi i ri i Policisë së Shtetit, vijimi i rindërtimit të Policisë Vendore Shkodër por edhe rindërtimin e një sërë komisarjatesh në vend duke bërë një riorganizim të strukturave të policive vendore dhe komisarjateve i ngjashëm me projektin e bërë për qendrat shëndetësore të shkollave në vend që do të bëhen me blloqe, dhomat e shoqërimit dhe blloku i sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ristrukturimin e Prefekturës Tiranë, investim për ndërtimin e godinës së re të SHÇBA-së, përfundimi i rikonstruksionit të godinës për Komisarjatin RENEA.

Do ketë investime të rëndësishme në armatime dhe pajisje për policinë e rendit, të kufirit, rritje të numrit të mjeteve në 150 mikrobusë dhe 50 fuoristrada etj. Prioritet tjetër që mbështetet me këtë buxhet është kontrolli i flukseve migratore, migracionit të parregullt, do të ketë investime në pikën e kalimit kufitar Qafë Botë në shumën 32 milion lekësh, forcim të kapaciteteve të Policisë Kriminale dhe Policisë Shkencore me pajisje dhe mjete të reja.

Po ashtu kemi rritje të fondeve përse i përket Gardës së Republikës, Zyrës së Gjendjes Civile si dhe rritje kapacitetesh me 27 efektivë shtesë për Gardën e Republikës dhe 31 punonjës për SHÇBA-në.

Gjithashtu në mbledhje u diskutua edhe për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, pasi ky i fundit i është drejtuar Komisionit për Sigurinë Kombëtare më shkresën nr.246 prot., datë 20.11.2019 ku paraqet nevojën që ky organ ka, për një shtesë fondi pagash për anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Sekretariatit Teknik e cila reflektohet në shtesë fondi buxhetor në zërin 600 (paga) dhe 601 (sigurimet shoqërore) në kodin buxhetor nr.16 të Ministrisë së Brendshme, programi 03140 “Policia e Shtetit” si dhe mundësinë e shtimit të personelit me 15 punonjës (5 këshilltarë ekonomikë, 5 këshilltarë ligjorë dhe 5 staf mbështetës administrativ) që mund të merret nga fondi rezervë i numrit të parashikuar të punonjësve për vitin 2020.

SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR

Shërbimit Informativ Shtetëror për vitin 2020 i është akorduar një buxhet në shumën 1,754,500 lekë, buxhet ky që krahasuar me vitin 2019 vjen në rritje me 179,500 lekë. Rritja e buxhetit (në terma të përgjithshme) tregon qartë synimin e qeverisë për forcimin dhe modernizimin e këtij shërbimi si nevojë për t'iu përgjigjur sfidave të rëndësishme në çështjet e sigurisë.

Megjithatë, SHISH gjatë parashtrimit të buxhetit për vitin 2020, me qëllim realizimin me sukses të objektivave për vitin 2020, kërkoi mbështetje për një shtesë fondi në shpenzime dhe investime mbi limitin e përcaktuar, në shumën 59.030 mijë lekë.

AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE

Autoriteti ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit Nr.9880/2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", Ligjit Nr.107/2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara" si dhe Ligji Nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike" dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Autoritetit garanton sigurinë për shërbimet e besuara, në veçanti për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në transaksionet elektronike ndërmjet qytetarëve, biznesit dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike e private dhe tregtisë elektronike si dhe përcakton standardet minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve kompjuterike të shoqërisë së informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt elektronik.

Buxheti i akorduar për këtë institucion është në masën 111,029 lekë, duke bërë të mundur përmbushjen e misionit të tij.

➤ PËRFUNDIME

Nga dëgjesat e kryera, Komisioni vlerëson se buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Shërbimin Informativ Shtetëror, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike mundëson përmbushjen e objektivave të secilit prej institucioneve dhe krahasuar me vitet e kaluara ka ardhur në rritje.

✚ Komisioni për Sigurinë Kombëtare i sugjeron Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, të ketë në konsideratë kërkesat për rritje fondesh për :

- **Shërbimin Informativ Shtetëror:**

SHISH kërkon mbështetje për një shtesë fondi në shpenzime dhe investime mbi limitin e përcaktuar, **në shumën 59.030 mijë lekë.**

Nisur nga objekti dhe misioni i këtij institucioni, Komisioni sheh të arsyeshem dhe kërkon marrjen në konsideratë **të një rritje në artikullin 231 “Investime” në shumën 30,000 mijë lekë,** pasi ky investimi në një sistem të klasifikuar do të rris performancën në punë duke sjell një produkt informativ inteligjent, cilësor dhe të shpejtë, si dhe do të rrisë sigurinë e rrjetit informatik ku prodhohet dhe qarkullon informacioni i klasifikuar.

- **Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit**

Me qëllimin e kryerjes së detyrës brenda afatit 1 vjeçar që është parashikuar me ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar”, afat ky që mbaron në qershor 2020, **komisioni sugjeron shikimin e mundësisë së shtimit të personelit me 15 punonjës (5 këshilltarë ekonomikë, 5 këshilltarë ligjorë dhe 5 staf mbështetës administrativ).**

- **Ministrinë e Mbrojtjes**

Ministria e Mbrojtjes kërkon që një pjesë të buxhetit për Forcat e Luftimit ta kalojë për arsimin ushtarak. Në lidhje me vlerën konkrete do të ketë një komunikim nga Ministria e Mbrojtjes.

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash vendosi të miratojë në parim pr/ligjin për buxhetin e vitit 2020 me sugjerimet përkatëse dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Relator

Elona GJEBREA (HOXHA)

Xhemal QEFALIA

Sadi VORPSI

Luan HARUSHA

Luan DUZHA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë, më 22.11.2019
Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

(shqyrtimi nen për nen)

Drejtuar : Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Bazuar në nenin 79 pika 2 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit, në datën 22 nëntor 2019, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshëm, Ministrisë së Mbrojtjes dhe përfaqësues të Shërbimit Informativ Shtetëror.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në:

- nenet 78, 83, pika 1, 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Nenin 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

➤ **OBJEKTIVAT E BUXHETIT 2020**

Projekt-buxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra gjatë 6 viteve të kaluara duke pasur në fokus rritjen ekonomike, punësimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe sjelljen më afër qytetarit të shërbimeve publike si dhe përmbushjen e prioriteteve në funksion të procesit për integrimin në Bashkimin Europian.

Shpenzimet buxhetore për periudhën 2020-2022 kanë në fokus investimet publike që kanë të bëjnë me:

- Finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale
- Mbështetjen e sektorit të ujit
- Shëndetësisë
- Arsimit
- Bujqësisë

Projektbuxheti 2020 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe uljen e informalitetit, e në të njëjtën kohë synon nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Është e rëndësishme të theksohet se projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë, si: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020 ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në 2020.

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të pestin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të pestin vit rradhazi. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritët të ulet në nivelin e 62.2% të PBB.

Projektbuxheti 2020, planifikon më shumë burime të ardhurash si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi.

➤ **PËRFUNDIME**

Pasi dëgjoi mendimin e përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të tij, **Komisioni për Sigurinë Kombëtare**, vendosi me shumicë votash ta miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për Buxhetin e vitit 2020 dhe t'ia përcjell komisionit përgjegjës dhe seancës plenare me sugjerimet si vijon:

• **Ministrinë e Mbrojtjes**

Ministria e Mbrojtjes kërkon që një pjesë të buxhetit për Forcat e Luftimit ta kalojë për arsimin ushtarak. Në lidhje me vlerën konkrete do të ketë një komunikim nga Ministria e Mbrojtjes.

- **Shërbimin Informativ Shtetëror:**

SHISH kërkon mbështetje për një shtesë fondi në shpenzime dhe investime mbi limitin e përcaktuar, **në shumën 59.030 mijë lekë.**

Nisur nga objekti dhe misioni i këtij institucioni, Komisioni sheh të arsyeshem dhe kërkon marrjen në konsideratë **të një rritje në artikullin 231 “Investime” në shumën 30,000 mijë lekë,** pasi ky investimi në një sistem të klasifikuar do të rris performancën në punë duke sjell një produkt informativ inteligjent, cilësor dhe të shpejtë, si dhe do të rrisë sigurinë e rrjetit informatik ku prodhohet dhe qarkullon informacioni i klasifikuar.

- **Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit**

Me qëllimin e kryerjes së detyrës brenda afatit 1 vjeçar që është parashikuar me ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar”, afat ky që mbaron në qershor 2020, **komisioni sugjeron shikimin e mundësisë së shtimit të personelit me 15 punonjës (5 këshilltarë ekonomikë, 5 këshilltarë ligjorë dhe 5 staf mbështetës administrativ).**

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare në përfundim të diskutimeve, me shumicë votash vendosi të miratojë nen për nen dhe në tërësi pr/ligjin për buxhetin e vitit 2020 me sugjerimet përkatëse dhe dërgimin e këtij raporti Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe seancës plenare.

Relator

Elona GJEBREA (HOXHA)

Xhemal QEFALIA

Sadi VORPSI

Luan HARUSHA

Luan DUZHA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ